



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**Drejtuar: Komisionit Rregullator**

**Re: Njoftim për thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator**

E nderuar Kryetare e Rregullatorit,

**Data**  
03.12.2020

Të nderuar anëtarë,

**Nr. Protokollit**  
2183

Në mbështetje të shkronjës "c", të paragrafit 1 të nenit 19 të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni, se janë përgatitur projektaktet:

1. Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet,
2. Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në KZAZ dhe KQV.

Bazuar në shkronjën "a", paragrafi 2, të nenit 20 të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, miratimi i projektaktet është kompetencë e Komisionit Rregullator, për këtë arsye propozoj thirrjen e mbledhjes për shqyrtimin e këtij projektakti.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektakteve dhe të relacioneve shoqëruese.

Materialet e mbledhjes ju vihen në dispozicion nga sekretaria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe mund t'i gjeni në faqen e KQZ-së në internet [www.cec.org.al](http://www.cec.org.al) në rubrikën e Njoftimeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**